

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PUNES

I. Rregullat baze te marredhenieve ndermjet Klientit dhe Bankes

1. Fusha e aplikimit, modifikimet ose amendimet

1.1 Fusha e aplikimit

- a) Keto kushte te pergjithshme te punes (ketu e me poshte referuar si “KPP”) do te aplikohen per te gjitha marredheniet e biznesit ndermjet Klientit dhe Bankes.
- b) Kushtet e veçanta qe mund te percaktohen ne marreveshje te veçanta qe lidhen me Klientin, ose kushtet e tjera te aplikuara per produkte dhe sherbime specifike, do te mbizoterojne mbi KPP.
- c) Ne keto KPP, “Banka” nenkupton Raiffeisen Bank sh.a. ndersa termi “Klient” do te perfshije individet, personat fizike si dhe personat juridike, sipas kuptimit ligjor te ketyre termave.

1.2 Modifikimet ose amendimet

- a) Eshte ne diskrecionin e Bankes te beje ndryshime ne KPP. Ne keto raste Banka do te njoftoje me shkrim Klientin, te pakten 15 dite perpara hyrjes ne fuqi te ndryshimeve.
- b) Modifikimet ose amendimet e ketyre KPP do te hyjne ne fuqi mbas njoftimit te klientit, dhe do te kene efekt per te gjitha marredheniet aktuale dhe te ardhshme te biznesit pervec rasteve kur banka ka marre nje njoftim me shkrim nga Klienti gjate kesaj periudhe, nepermjet te ciles njofton zgjidhjen e kontrates me Banken.

2. Njoftimet

2.1 Njoftimet e Bankes

- a) Njoftimet, shkresat, lajmerimet, si dhe çdo lloj komunikimi tjeter i Bankes me Klientin jane te vlefshme kur behen ne adresen e treguar nga Klienti ne momentin e hapjes se llogarise, apo ne adresen e njoftuar nga Klienti, ne rast se ka patur ndryshime.
- b) Ne rast se llogaria eshte intestuar ne emer te disa Klienteve, njoftimet sipas pikes a) me siper, do te dergohen ne adresen e njerit prej tyre, dhe do te kene efekt te plote per te gjithë titullaret e llogarise.

2.2 Urdhrat dhe instruksionet e Klientit

- a) Udhurat dhe instruksionet e Klientit si rregull duhet te jepen me shkrim dhe te permbajne nenshkrimet origjinale te personave te autorizuar.
- b) Pavaresisht nga kjo Banka do te kete te drejte te zbatoje edhe instruksione te dhena nepermjet rrugeve te tjera te komunikimit (ne veçanti, me telefon, e-mail, internet), ne rastet kur Klienti ka lidhur nje marreveshje te veçante me Banken per keto sherbime.
- c) Rregullat ne lidhje me komunikimin me telefon; e-mail, internet etj. percaktohen ne procedurat perkatese te Bankes si dhe ne Kushtet e Punes, me te cilat Klienti njihet ne momentin e aplikimit per keto lloj sherbimesh.

3. Detyrimi per te bashkepunuar dhe pergjegjesite e Klientit

3.1 Detyrimet e Klientit per te njoftuar Banken

Ne marrëdhëniet e tij me Banken, Klienti duhet të zbatohet detyrimin për të bashkëpunuar dhe njoftuar Banken në lidhje me ndryshimet e rëndësishme si më poshtë. Çdo shkelje e kësaj dispozite do të çojë në detyrimin e Klientit për të paguar demet që mund të shkaktohen ose në reduktimin e pretendimeve të Klientit kundrejt Bankes.

a) Emri dhe adresa

- Klienti do të njoftojë menjëherë bankën me shkrim për çdo ndryshim të emrit të tij, emrit të shoqërisë, adresës ose adresave të shërbimit të njoftuara nga ana e tij.
- Nëse klienti nuk njofton ndryshimet e adresës, komunikimet me shkrim të bankës do të konsiderohen të marra, nëse janë dërguar në adresën e njoftuar për herë të fundit nga Klienti.

b) Kufijte e përfaqësimit

- Klienti do të njoftojë menjëherë bankën me shkrim për çdo anulim apo ndryshim të pushtetit të përfaqësimit, në mënyrë të veçantë autoritetin për të nënshkruar në emër të Klientit për veprimet në llogari, dhe do t'i japë Bankes dokumentacionin përkatës për këtë qëllim.
- Çdo pushtet përfaqësues i njoftuar bankës do të vazhdojë të jetë në fuqi në fushën përkatëse deri në njoftimin me shkrim për anulimin apo ndryshimin e tyre.

c) Aftësia për të hyrë në transaksione legale

- Banka do të njoftohet menjëherë me shkrim për çdo humbje apo reduktim të aftësisë (zotësisë juridike) të klientit për të hyrë në transaksione ligjore me Banken. Nëse Klienti është një kompani ose entitet ligjor, shpërndarja e tyre gjithashtu do t'i njoftohet menjëherë Bankes.

3.2 Qartësia e urdhrave

- a) Klienti do të sigurojë që urdhrat / instruksionet që do t'i japin Bankes do të jenë të qarta dhe jo të dykuptimta. Modifikimet, konfirmimet ose kujtesat duhet të jenë shënuar në mënyrë të veçantë si të tilla.
- b) Nëse Klienti dëshiron t'i japë bankës instruksione speciale në lidhje me zbatimin e urdhrave, ai do të informojë bankën në mënyrë të veçantë dhe të përcaktuar. Kjo, në radhë të parë, aplikohet nëse zbatimi i urdhrave është jashtëzakonisht urgjent ose subjekt i periudhave apo afateve kohore të caktuara.

3.3 Kujdesi në përdorimin e mjeteve të telekomunikacionit

- a) Nëse Klienti jep instruksione ose njoftime të tjera në rrugë telekomunikacioni, ai do të marrë masa të përshtatshme parandaluese me qëllim që të shmangin gabimet e transmetimit dhe abuzimet.

3.4 Paraqitja e kundërshtimeve

- a) Klienti do të verifikojë menjëherë njoftimet e bankës, siç janë konfirmimet e urdhrave të tij, komunikimet lidhur me zbatimin e tyre, nxjerrjen e llogarise, për të verifikuar plotësinë dhe rregullshmerinë e tyre dhe do të paraqesë kundërshtimet pa vonesë, nëse do të ketë.
- b) Nëse banka nuk merr kundërshtime me shkrim brenda 3 muajve, duke filluar nga dita e fundit e muajit kur është kryer transaksioni, njoftimet dhe shërbimet e deklaruara të bankës do të konsiderohen të aprovuara.
- c) Banka në çdo rast do të informojë Klientin në lidhje me rëndësinë e kundërshtimit, ose moskundërshtimit, nëpërmjet kontratave, marrëveshjeve apo kushteve të punës për shërbimet përkatëse që ofrohen nga Banka. Një informacion i tillë do të jepet edhe në nxjerrjet e llogarise.

3.5 Njoftimet ne rast mungese te komunikimit

Klienti do ta njoftoje menjehere banken nese ai nuk merr komunikime te rregullta, postë nga banka, ose komunikime te tjera te cilat duhet te kishin mbrritur tek Klienti brenda nje periudhe normale kohe pritje, ne perputhje me format e rena dakord te njoftimit.

3.6 Perkthimet

Dokumentet ne gjuhe te huaj do te paraqiten ne banke edhe ne gjuhen shqipe, te perkthyer dhe noterizuara, nese banka e kerkon keshtu.

4. Mbarimi i marredhenieve te biznesit

4.1 .Mbarimi nga ana e bankes

a) Mbarimi i zakonshem (i thjeshte)

Pervec rasteve kur marreveshja ka qene perfunduar per nje periudhe te percaktuar kohe, Banka dhe Klienti do te kene te drejte te zgjidhin ne çdo kohe marredhenien e biznesit ne teresi, ose pjese te vecanta te saj, duke njoftuar palen tjetër brenda nje periudhe te arsyeshme njoftimi.

b) Mbarimi per arsye te rendesishme

- Banka dhe Klienti do te kene te drejte te zgjidhin ne çdo kohe marredhenien e biznesit ne teresi, ose pjese te vecanta te saj, me efekt te menjehershëm, per arsye te rendesishme, me perjashtim te rasteve kur me marreveshje eshte vendosur ndryshe.
- Arsye te rendesishme per perfundimin nga ana e bankes, konsiderohen rastet kur klienti eshte duke e perdorur llogarine per aktivetete te kunderligjshme; ka shkelur ne menyre te perseritur KPP, ose kushtet e veçante qe jane aplikuar; kur klienti jep informacione jo korrekte rreth gjendjes se tij financiare ose fakteve dhe rrethanave te tjera thelbesore; rastet kur situata financiare e Klientit ose e nje bashke-debitori perkeqesohet ose eshte vene ne rrezik dhe permbushja e detyrimeve ne lidhje me banken eshte vene ne rrezik nga kjo gje; ose rastet kur Klienti deshton ose eshte i paafte te permbushe detyrimin per te dhene apo per te rritur kolateralin.

4.2. Pasojat ligjore

Me perfundimin e gjithe marredhenieve te biznesit ose nje pjese te tyre, shumat qe palet i detyrohen njera tjetres detyrohen do te behen menjehere te pagueshme dhe Klienti do te jete i detyruar te shlyeje te gjitha detyrimet e papaguara kundrejt Bankes.

5. Te drejtat e disponimit mbas vdekjes se klientit

5.1 Disponimi ne favor te trashegimtareve

- a) Ne rast vdekje te Klientit, Banka do te lejoje kalimin e shumave ne favor te trashegimtareve, ne baze te vendimit te gjykates per leshimin e deshmise se trashegimise.
- b) Me vdekjen e nje klienti qe eshte titullar i nje llogarie me person te autorizuar, mbarojne edhe te drejtat e personit te autorizuar, per te vepruar me llogarine. Banka eshte e detyruar te refuzoje kryerjen e veprimeve nga Personi i Autorizuar, qe nga momenti i marrjes dijeni per vdekjen e klientit.

II. HAPJA DHE MIREMBAJTJA E LLOGARIVE

6. Fusha e aplikimit

6.1 Perderisa nuk eshte parashikuar ndryshe, rregullat e meposhtme ne lidhje me llogarite do te aplikohen edhe per llogarite e letrave me vlere.

7. Hapja e llogarive

- a) Llogaria bankare do te mbaje emrin e Klientit dhe do te kete nje numer te caktuar llogarie. Kur hapet nje llogari, mbajtesi i ardhshem i llogarise do te provoje identitetin e tij.
- b) Banka do te kete te drejte te verifikoje identitetin e Klientit me ane te dokumenteve te identifikimit, ne momentin e hapjes se llogarise apo vendosjes se marredhenieve te biznesit, si dhe ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara me ligj.
- c) Per qellime te marrjes se te dhenave mbi të, Banka do te kerkoje nga Klienti vetem dokumente origjinale ose fotokopje te noteruara/legalizuara te tyre.
- d) Banka do te kete te drejte, qe ne rastet kur e gjykon te arsyeshme, te kerkoje nga Klienti paraqitjen e dokumenteve te tjere identifikuese me qellim verifikimin e te dhenave te paraqitura nga Klienti.
- e) Banka nuk hap llogari anonime, qofshin keto me numra apo nen emra fiktive. Banka ka te drejte te refuzoje hapjen e nje llogarie, kur karakteristikat e klientit nuk jane ne perputhje me standartet e Bankes, apo per ndonje shkak tjetër te arsyeshem, pa qene e detyrueshme t'i jape shpjegime Klientit.
- f) Banka identifikon klientin, çdo here qe ky paraqitet ne sportelet e Bankes. Banka ka te drejte te mos zbatoje urdhrin e Klientit per kryerjen e transaksioneve financiare, nese identiteti i Klientit nuk eshte verifikuar plotesisht.

8. Specimeni i nenshkrimit

Personat qe jane te autorizuar te administrojne ose te nenshkruajne per nje llogari, do te depozitojne nenshkrimet e tyre ne banke. Bazuar ne nenshkrimin e depozituar, Banka do te lejoje disponimin e llogarise sipas urdhrave te personave te autorizuar te Klientit.

9. Te drejtat e administrimit dhe autoriteti i nenshkrimit

9.1 Te drejtat e administrimit

- a) Vetem mbajtesi i llogarise do te kete te drejte te administroje llogarine.
- b) Vetem personat e drejta e perfaqesimit te te cileve eshte bazuar ne parashikime statutore ose personat qe kane nje prokure nepermjet te ciles jane autorizuar ne menyre te shprehur te administrojne llogarine, do te kene te drejte te perfaqesojne mbajtesin e llogarise. Ata do te jene te detyruar te provojne identitetin e tyre dhe te drejtat e perfaqesimit.
- c) Llogarite e te miturve do te administrohen nga perfaqesuesit e tyre ligjore ose kujdestaret. Kufizimet me ligj te te drejtave te perfaqesuesve ligjore ose kujdestareve, do te respektohen nga ana e Bankes.

9.2 Autoriteti i nenshkrimit

- a) Mbajtesi i llogarise mund t'ia delegoje paleve te treta autoritetin per te nenshkruar. Personi i autorizuar ka te drejte te nenshkruaje per llogarine, brenda tagrave te perfaqesimit qe i jane dhene nga mbajtesi i llogarise.

- b) Klienti do të jetë përgjegjës për të njoftuar menjëherë Bankën për çdo ndryshim në lidhje me personat e autorizuar. Në rast të kryerjes së veprimeve nga persona të autorizuar, tagrat e të cilëve në momentin e kryerjes së veprimit kishin mbaruar, Banka do të përjashtohet nga çdo lloj përgjegjësie kundrejt klientit dhe/ose paleve të treta, në rast se nuk ka qenë njoftuar në kohë nga ana e Klientit.

10. Llojet e llogarive

10.1 Numri i llogarive

Një Klient mund të hapë disa llogari në emër të një Klienti, në të njëjten monedhë ose në monedha të ndryshme, në të njëjten dege ose në dege të ndryshme.

10.2 Llogarite escrow

Llogarite escrow janë llogari që shërbejnë për depozitimin e fondeve në baze të marrëveshjeve me shkrim që mund të lidhen ndërmjet Bankës, Klientit dhe paleve të treta. Në këto raste, Banka do të veprojë si agjent escrow në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet përkatëse.

10.3 Llogarite në monedhë të huaj

- a) Nëse Banka mban një llogari në monedhë të huaj për klientin, transfertat në llogarite respektive në monedhë të huaj do të kreditohen në një llogari të tillë, për sa kohë nuk është dhënë një instruksion i ndryshëm transferimi.
- b) Nëse nuk ekziston ndonjë llogari në monedhë të huaj, banka do të ketë të drejtë të kreditojë shumat në monedhë të huaj në monedhën kombëtare, duke kryer konvertimin me kursin e këmimit në fuqi në datën e kryerjes së transaksionit, nëse nuk është autorizuar për të kundërtën nga klienti.

11. Nxjerrjet e llogarive

- a) Banka ka për detyrë ta pajisjë Klientin me nxjerrje të llogarive, një herë në muaj, në të cilën janë pasqyruar në mënyrë të detajuar të gjitha transaksionet e kryera në llogari për periudhën respektive. Klienti është i detyruar ta terheqë nxjerrjen e llogarive pranë Bankës.
- b) Klienti do të njoftojë Bankën me shkrim nëse ka pretendime mbi balancën e llogarive ose transaksione të ndryshme të pasqyruara në nxjerrjen e llogarive, brenda 3 muajve nga dita e fundit e muajit kur është kryer transaksioni që kontestohet. Në mungesë të kundërshtimeve, nxjerrja e llogarive do të konsiderohet e aprovuar dhe pranuar nga Klienti.

12. Bllokimi / sekuestrimi i llogarive

- a) Banka do të ketë të drejtë të pezullojë kryerjen e veprimeve në llogari (block debit), në rastet kur konstatohet se ka mungesë të dokumentacionit të Klientit, apo mosmarrëveshje në lidhje me të drejtat e përfaqësimit.
- b) Pezullimi do të zgjidhet deri në paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar, apo deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar.
- c) Banka ka të drejtë të bllokojë/sekuestrojë llogarive të një Klienti, në rastet e ekzekutimeve të detyrueshme mbi shumat e llogarive në banka, në përputhje me aktet ligjore të nenligjore që rregullojnë ekzekutimin e detyrueshëm; si dhe me urdher të Autoriteteve Shtetërore që e kanë një të drejtë të tillë me ligj.

- d) Per kryerjen e veprimeve te bllokimit/sekuestrimit te llogarise, sipas pikes 13.3, Banka do te njoftoje me shkrim Klientin

13. Kompensimi

- a) Ne rast se midis Bankes dhe Klientit ekzistojne disa marredhenie ose llogari, edhe ne monedha te ndryshme, tepricat aktive dhe passive kompensohen. Banka ka te drejte te debitoje balancat e llogarive te Klientit ne menyre qe te mbylle balancat denitore te nje ose me shume llogarive te Klientit.

14. Llogarite e palevizshme

Ne rastet kur Klienti nuk ka kryer asnje veprim me llogarine rrjedhese per me shume se 180 dite, llogaria kalon automatikisht me status inaktiv. Llogaria do te riaktivizohet ne rast kreditimi te llogarise, ose me kerkese te vete Klientit.

Banka ka te drejte te mbylle llogarine inaktive ne rast se balanca e saj eshte zero ose debitore, duke bere më parë rimbursimin e komisioneve dhe interesave debitore te perlllogaritura gjate kesaj periudhe.

III. TRANSAKSIONET ME XHIRIM

15. Urdhrat e transferimit

- a) Urdhrat e transferimit do te permbajne emrin e bankes se perfituesit, numrin e llogarise, adresen, IBAN-in, kodin SWIFT, si dhe emertimin e plote te llogarise se perfituesit.
- b) Urdhrat e transferimit duhet te jene nenshkuara nga personi qe ka tagrin dhe mban Autoritetin e Nenshkrimimit te Klientit nderkohe qe, vetem per rastet e klienteve te segmentuar si Korporate & SE, paraqitja e ketij te fundit fizikisht ne Banke per depozitim e ketyre urdhrave nuk eshte domosdoshmeri. Ne nje rast te tille Klienti mund te zgjedhe persona te trete qe te paraqiten fizikisht ne Banke per te depozituar urdher transfertat e plotesuara, persona te cilet Banka nuk mbart asnje detyrim t'i identifikojte apo verifikojte. Klienti kupton se kjo forme dergese perben risk te larte per te dhe se mbetet pergjegjesi e vetme e tij tregimi i kujdesit maksimal ne menyren se si/me ke vendos te depozitote keto urdhra si dhe te sigurohet qe keta individe qe te mos largohen nga Banka pa marre kopjen e procesuar te urdher transfertes. Ne kete kuader, Klienti jep miratimin e tij te pakushtezuar dhe te parevokueshem se Banka shkarkohet nga cdo pergjegjesi per cdo humbje apo dem eventual (monetar apo jo) qe mund t'i shkaktohet Klientit si pasoje e kesaj zgjedhjeje te tij.
- c) Vetem pranimi i nje urdher transferimi nga banka, nuk do te çojte ne ndonje te drejte te nje pale te trete kundrejt bankes.
- d) Banka do te jete e detyruar te zbatoje nje udhezim transferimi vetem nese ne llogarine e klientit (balance kreditore/linje kredie e miratuar) jane ne dispozicion fonde te mjaftueshme per te mbuluar gjithe shumen.

16. Kreditimet e llogarise dhe e drejta per te anuluar

- a) Ne rast se ekziston nje marreveshje e vlefshme mirembajtje llogarie, Banka do te jete e detyruar dhe do te kete te drejte ne menyre te pakthyeshme te pranoje shumat e parave ne emer te klientit dhe te kreditoje llogarine e tij per keto shuma.
- b) Urdhri per t'i dhene nje klienti nje shume parash do te kryhet nga banka nepermjet kreditimit te shumes ne llogarine e perfituesit, perveç rasteve kur eshte treguar ndryshe ne urdhrin perkates.
- c) Banka do te kete te drejte te anulloje, ne çdo kohe, çdo hyrje kreditore te bere si rezultat i nje gabimi te saj.
- d) Ne raste te tjera banka do te anulloje hyrjen kreditore vetem nese paefektshmeria e urdhrin te transferimit eshte qartesisht e provuar. E drejta per te anuluar nuk do te perjashtohet nga balancimi i llogarise qe mund te ndodhe nderkohe. Nese e drejta per te anuluar ekziston, banka mund te kundërshtojë te drejten per te disponuar shumat e kredituara.

17. Debitimet e llogarise

Ne rastet e urdhrave te transferimit, debitimet e llogarise do te konsiderohen nje konfirmim se urdhrat jane zbatuar.

18. Pergjegjësia e Bankes

Banka nuk do te jete pergjegjese per ndonje humbje ose dem te shkaktuar Klientit, si rrjedhoje e voneses apo deshtimit te Bankes per te permbushur detyrimet e saj, per shkak te rrethanave qe nuk varen nga Banka, dhe qe perfshijne por nuk kufizohen ne: fatkeqesi natyrore, ngjarje te jashtezakonshme, trazira sociale, avari ne sisteme ose pamundesi per trasmetim ose komunikim me pale te treta.

IV. PAGESAT PER SHERBIMET, DHE RIMBURSIMI SHPENZIMEVE

19. Pagesa

19.1 Rregulla te pergjithshme

- a) Banka do te kete te drejte te kerkoje pagese nga klienti per sherbimet e tij, ne veçanti, interesat, tarifat dhe komisionet.
- b) Kjo do te aplikohet gjithashtu edhe per sherbimet e nevojshme, qe behen nga banka pa nje urdher te klientit, por ne raste nevojë te ngutshme ose ne perfitim te klientit ose per mbylljen e llogarise se nje klienti te vdekur.

19.2 Shuma e pageses

- a) Banka do te kete te drejte per nje pagese te pershtatshme per sherbimet e saj, shuma e te ciles do te percakohet nga banka dhe do te shpallet ne formen e nje liste qe permban çmimet per sherbime te caktuara.
- b) Detyrimet e Bankes sipas rregulloreve te veçanta, per te shprehur te tilla çmime ne nje marreveshje llogarie rrjedhese, marreveshje kredie, depozite etj. do te mbeten te pacenuara nga ky percaktim.

19.3 Ndryshimi i pageses per sherbimet

- a) Banka do te kete te drejte qe ne diskrecionin e vet te arsyeshem te ndryshoje pagesat e caktuara per sherbimet qe u ofron ne menyre te vazhdueshme klienteve (interesi, komisioni i

mbajtjes se llogarise, etj.) duke mbajtur parasysh rrethanat perkatese (ne vecanti, ndryshimet ne kuadrin ligjor, ndryshimet ne tregun e parase ose tregun e kapitalit, ndryshimet ne koston e refinancimit, ndryshimet ne shpenzimet e stafit dhe shpenzimet operative, etj.).

- b) Interesat qe jane per t'u paguar nga klientet mund te ndryshohen ne perputhje me kushtet per te cilat eshte rene dakord ne menyre specifike me klientin.
- c) Çdo ndryshim i pagesave do te hyje ne fuqi mbas njoftimit me shkrim te klientit per ndryshimin e vendosur nga banka. Ne njoftimin e saj banka do ta informoje klientin per ndryshimin e tarifave, dhe do te theksoje se mbas mbarimit te afatit te parashikuar, pranimi i heshtur do te konsiderohet dhenie e pelqimit per ndryshimin.

20. Rimbursimi i shpenzimeve

20.1 Ne ngarkim te klientit do te jene te gjitha shpenzimet dhe koston, ne menyre te veçante taksat, tarifat ligjore, shpenzimet e postes, koston e sigurimit, tarifat e regjistrimit ne ZRPP si dhe sherbimet e konsulences ne çeshtjet e administrimit te biznesit, qe rrjedhin nga marredheniet e biznesit ndermjet tij dhe bankses.

V. KOLATERALI

21. E drejta e kolateralit

- a) Banka do te kete te drejte te kerkoje nga Klienti dhenien e kolateralit perkates per te gjitha pretendimet qe krijohen nen marredheniet e biznesit brenda nje periudhe te caktuar kohe, edhe ne qofte se detyrimet jane te kushtezuara, me afat ose nuk jane bere akoma te kerkueshme.
- b) Klienti eshte i detyruar te siguroje permbushjen e detyrimeve te tij kundrejt Bankses me ane te garancive, qe perfshijne hipotekimin e pasurive se paluajtshme, vendosjen e barres siguruese mbi pasuri te luajtshme, apo garanci te tjera sipas menyres se rene dakord ndermjet paleve, ne perputhje me marreveshjet e veçanta qe lidhen per kete qellim.
- c) Sigurimi i kredise nepermjet vendosjes se hipotekes mbi pasurite e paluajtshme, mund te behet si mbi pasurite e Klientit, ashtu edhe mbi pasurite e paleve te treta. Klienti / hipotekuesi i njohur ligjerisht si pronar i pasurise, duhet ta hipotekojte ate te lire nga çdo barre apo detyrim tjetër te lidhet me të. Klienti / hipotekuesi detyrohet te mos shese, apo te disponoje me çfaredolloj menyre tjetër pjese apo te gjitha pasurite apo pjese te drejta te saj mbi pasurite.
- d) Klienti / hipotekuesi nuk do te kete te drejte ta pakesoje vleren e pasurise se hipotekuar, perveçse ta shtojte ate. Banka do te kete te gjitha te drejtat qe i njeh ligji mbi pasurine e hipotekuar ne favor te saj, bashke me te gjitha permiresimet, ndertimet e shtesat e tjera aktuale dhe te ardhme te kryera mbi të.
- e) Banka do te kete te drejte t'i kerkoje Klientit te siguroje kolateralin e tij, si dhe jeten, kundrejt çdo risku ne shoqerite siguruese qe Banka e gjykon te arsyeshme. Klienti do te pranoje qe çdo kompensim qe rrjedh nga kontrata e sigurimit t'i kaloje Bankses dhe se ai nuk do te kete asnje te drejte mbi të.

22. Barra siguruese

- a) Kur sigurimi i kredise eshte bere me ane te krijimit te barres siguruese mbi pasuri te luajtshme te Klientit, ky i fundit bie dakord t'i kaloje Bankses titullin mbi pasurine e luajtshme dhe frutat civile qe rrjedhin prej saj per te garantuar pagesen dhe permbushjen e plote te

detyrimit të saj kundrejt Bankes. Për sa kohë që kredia është e papermbushur, Banka do të jetë titullare e pasurisë së luajtshme.

- b) Në rast se barra sigurore konsiston në një barë mbi një depozitë bankare apo bono thesari, Klienti do të autorizojë Bankën që të preke pa asnjë paralajmërim depozitën apo bonot e thesarit, në rast të mospermbushjes së detyrimeve.

23. Rritja e kolateralit

- a) Në varesi të rrethanave të cilat justifikojnë një vlerësim të rritur të riskut të pretendimeve kundrejt klientit, Banka do të ketë të drejtë të kërkojë dënim ose rritjen e kolateralit brenda një periudhe të arsyeshme kohë. Në mënyrë të veçantë, kjo do të jetë rastet kur është zvogëluar vlera e kolateralit, situata ekonomike e klientit është përkeqësuar ose rrezikon të përkeqësohet, ose nëse kolaterali i disponueshëm është përkeqësuar në vlerë ose rrezikon të përkeqësohet.
- b) Në rast mospermbushje të kësaj kërkesë të Bankës nga ana e Klientit, Banka do të ketë të drejtë të zgjidhë kontratën dhe të kërkojë kthimin e menjëhershëm të shumës së huasë, bashkë me detyrimet e tjera që janë bërë e kërkuar.

24. Lirimi i kolateralit

Në rast se nuk ka interes të justifikuar për mbajtjen si garanci, Banka do të kryejë veprimet për lirimin e kolateralit menjëherë mbas kërkesës së klientit.

25. Të drejtat e Bankës në rast mospermbushje

- a) Kur konstatohet ndonjëri prej rasteve të mospermbushjes, të cilat përcaktohen në kontratat e veçanta që lidhen ndërmjet Bankës dhe Klientit, Banka do të ketë të drejtë të ndërmarrë të gjitha veprimet që ajo i gëjkon të arsyeshme dhe / ose kërkojë kthimin e menjëhershëm të shumave që Klienti i detyrohet Bankës.
- b) Në rast se Klienti nuk përmbush detyrimet e tij kundrejt Bankës, banka do të ketë të drejtë të debitojë në çdo kohë, pa njoftim paraprak, çdo llogari të Klientit deri në masën e përmbushjes së plotë të detyrimit dhe / ose të fillojë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të kredisë, në përputhje me dispozitat e K.Pr. Civile.

VI. HUATE NE MONEDHA TE HUAJA

26. Pagesa e huave në monedhë të huaj

- a) Huatë në monedhë të huaj do të paguhet në monedhën në të cilën ato janë dhënë nga banka. Në momentin e marrjes së kredisë klienti informohet mbi rrezikun e huamarrjes në monedhë të huaj. Klienti duhet të lexojë me kujdes këtë informacion përpara nënshkrimit të kontratës.
- b) Banka ka të drejtë që në rast se klienti nuk paguan kështu e rrjedhës të debitoje llogaritë e klientit në çdo monedhë dhe t'i konvertojë në monedhën e pagesës së kredisë për të mundësuar pagesën e kështu të rrjedhës. Risku i kursit të këmimit bie mbi klientin.

VII. LLOJE TE VEÇANTA TE OPERACIONEVE DHE SHERBIMEVE

27. Fusha e Aplikimit

- a) Banka do te ofroje sherbime te ndryshme per Klientet, ne perputhje me licencen dhe me politikat e saj. Nje pjese e veçante e ketyre sherbimeve do te ofrohen vetem per kategori te caktuara klientesh, ne baze te kategorizimit qe behet nga ana e Bankes.
- b) Kushtet e Punes per keto sherbime do te percaktohen ne marreveshjet e veçanta qe do te nenshkruhen per kete qellim, me te cilat Klienti njihet ne momentin e aplikimit per keto sherbime, apo ne rregullat nderkombetare uniforme, ne rastet kur ato jane te aplikueshme.

VIII. SIGURIMI I DEPOZITAVE

28. Informacion mbi sigurimin e depozitave

- a) Depozitat e klienteve te bankes, si individ dhe biznes, jane te siguruar pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave sipas dispozitave të ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", I ndryshuar. Agjencia kompenson depozitat e siguruar, ne rastet kur Banka e Shqiperise vendos venien ne likuidim te Bankes,ose kur kjo e fundit likuidohet vullnetarisht.
- b) Agjencia kompenson depozitën e siguruar, sipas dispozitave të këtij ligji, jo më shumë se 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, për çdo depozitues, pavarësisht numrit të depozitave apo shumës së depozituar. Niveli i kompensimit për çdo Klient/depozitues (individ, biznes) llogaritet mbi shumën agregate të depozitave të siguruar të këtij depozituesi prane Bankes, pa marrë parasysh numrin e depozitave, si dhe llojin e monedhës së depozituar ose të pagueshme.
- c) Kompensimi per llogari te depozitave te siguruar fillon menjehere pasi Agjencia njoftohet me shkrim nga Banka e Shqiperise per nderhyrjen ose per vendimin e likuidimit vullnetar te Bankes. Procesi i kompensimit realizohet ne perputhje me procedurat e caktuara ne ligjin "Per sigurimin e depozitave" dhe ne aktet nenligjore perkatese. Kompensimi perfundon jo me vone se tre muaj nga data e fillimit te procesit te kompensimit.
- d) Kompensimi i depozites se siguruar kryhet: i) nepermjet transferimit te mases se kompensuar te depozites ne nje banke tjeter te siguruar; ii) nepermjet pagimit te shumes ne leke te personit, sipas nivelit te kompensimit; iii) nepermjet nje banke agjente te siguruar.
- e) Agjencia e Sigurimit te Depozitave eshte institucioni i krijuar me qellim qe te realizohet sigurimi i depozitave te klienteve dhe kompensimi i tyre, ne perputhje me kerkesat e ligjit. Roli kryesor i Agjencise se Sigurimit te Depozitave konsiston ne: i) mbrojtjen e depozituesve nga falimentimi i Bankes ku jane vendosur kursimet e tyre: ii) kompensimin e depozitave te tyre deri ne nivelin e nivelin e percaktuar ne ligj.

IX. RUAJTJA E SEKRETIT TE INFORMACIONIT TE KLIENTIT

29. Konfidencialiteti

- a) Banka do te siguroje konfidencialitetin ne lidhje me informacionin e klientit dhe te dhenat personale.
- b) Banka eshte e detyruar te jape nje informacion te tille vetem me autorizim te Klientit, ose me kerkese te organeve qe e kane kete te drejte me ligj.
- c) Detyrimi per te ruajtur sekretin e informacionit te Klientit do te vazhdoje edhe mbas perfundimit te marredhenies se Bankes me Klientin.

X. VENDI I EKZEKUTIMIT, LIGJI I ZBATUESHEM, VENDI I ZGJIDHJES SE MOSMARREVESHJES

30. Vendi i ekzekutimit

Vendi i ekzekutimit per te dyja palet do te jene zyrat e asaj dege te bankes, me te cilen transaksioni eshte perfunduar.

31. Zgjedhja e ligjit te zbatueshem

Te gjitha marredheniet ndermjet Klientit dhe Bankes do te jene subjekt i ligjit shqiptar.

32. Vendi i zgjidhjes se mosmarreveshjeve

Klienti mund te ngreje padi kunder Bankes vetem ne Gjykatën e Rrethit Tirane, ku eshte regjistruar selia e Bankes.

Keto Kushte te Pergjithshme Pune jane hartuar ne gjuhen shqipe dhe gjuhen angleze. Ne rast mosperputhje midis dy versioneve, do te mbizoteroje versioni ne gjuhen Shqipe.

Deklaroj se kam marre nje kopje te Kushteve te Pergjithshme te Punes, sot me date _____.

Klienti

Banka

Firma

Firma e punonjesit